



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.03.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ARITECH”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative”, Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “ARITECH”, e dt.05.01.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative”, Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, Nr. i brendshëm- 632-21-157-121, kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 15.03.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 15.03.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Me dt.21.03.2022, Operatori Ekonomik "ARITECH", ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative " , Nr. i prokurimit- 632-21-10162-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-21-157-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Grupi I Operatorëve ekonomik i perzgjedhur për lidhjen e kontratës ka të dorëzuar Autorizim të Lenovo i cili nuk është Autotentik, është I pa bazuar sepse Grupi I Operatorëve ekonomik "TECH VISION"shpk & Mehmet Sahitolli B.I & Nita Macula B.I., në ofertën e tyre të dorëzuar në AK, nuk kanë të prezantuar autorizim të Lenovo e asnjë autorizim tjetër, sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar në Dosjen e tenderit, prandaj nuk e kemi të qartë se ku jeni bazuar lidhur me pretendimin tuaj.

Autoriteti kontraktues nuk do të pranoj furnizime me asnjë autorizim tjetër përveq atij me të cilin Grupi I Operatorëve ekonomik në fjalë ka nënshkruar kontratë me AQP-në.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës